

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Sherbimi i ruajtjes me roje private te godines se Drejtorise se Shendetit Publik Lushnje dhe objekteve qe ndodhen nen administrimin e saj :- Godina e Poliklinikes Lushnje dhe Godina e DHE Lushnje si edhe gjithe vlera materiale brenda tyre, do te realizohet per periudhen kohore nga fillimi i nenshkrimit te kontrates deri me 31 dhjetor 2017 me 4 (kater) roje gjithsej me fond limit 1704500(nje milion e shtateqind e kater mije e peseqind) leke pa TVSH. Lista emerore e rojeve qe do te ruajnen objektet e lartpermendura do te paraqitet qe ne momentin e nenshkrimit te kontrates nga Operatori Ekonomik fitues dhe per cdo ndryshim do te njoftohet me shkrim prane Drejtorise se Shendetit Publik Lushnje.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shërbimi i ruajtjes me roje private do te jete i organizuar me tre turne te treta sipas specifikimeve ne shtojcën 8 DST për periudhen qe nga data e nenshkrimit te kontrates deri me 31 Dhjetor 2017. Pjesëmarrësit e paraqitur ne tender ne datën e zhvillimit te tij ne ofertat e tyre duhet te kenë parashikuar sipas legjislacionit ne fuqi pagën minimale, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore , vështirësitë e turneve sipas shtojcës 8 .Te gjitha ofertat qe nuk mbulojnë pagën minimale , kontributet e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore, vështirësitë e turnit do te quhen te pa vlefshme.



Shërbimi që kërkohet:

- Sherbimi i ruajtjes me roje private te godines se Drejtorise se Shendetit Publik Lushnje dhe objekteve qe ndodhen nen administrimin e saj qe jane: a) Godina e Poliklinikes Lushnje b) Godina e Higjenes Lushnje dhe Drejtorine e Shendetit Publik :
- ruajtja nga vjedhjet dhe demtimet e vlerave materiale qe ndodhen brenda ketyre godinave per periudhen nga nenshkrimi i kontrates deri me 31 Dhjetor 2017
- Sherbimi i ruajtjes me roje private do te jete i organizuar :
- Ne hyrje te godines se Drejtorise se Shendetit Publik Lushnje i organizuar vetem me nje turn te trete.Sherbimi do te kryhet me nje roje ne kete turn.
- Ne hyrje te Drejtorise se Higjenes Lushnje i organizuar me nje turn te trete. Sherbimi do te kryhet me nje roje ne turnin e trete. Roja do te mbuloj me sherbim ruajtjen e godines se Drejtorise se Higjenes Lushnje.
- Ne hyrje te Poliklinikes Lushnje i organizuar me nje turn te trete. Sherbimi do te kryhet me nje roje ne turnin e trete.
- Sherbimi gjate diteve te javes nga dita e hene deri te shtunen do te organizohet sipas specifikimeve te lartpermendura gjithashtu dhe ne ditet e djela dhe diteve te festave zyrtare. Autoriteti Kontraktor ka te drejten e ushtrimit te kontrollit ne cdo kohe per verifikimin e kryejes se sherbimit te ruajtes me roje.

Ne daten 3 te cdo muaji operatori ekonomik fitues duhet te sjell ne degen e finances se Drejtorise se Shendetit Publik Lushnje faturen dhe listen emerore te rojeve te siguruar qe kane kryer sherbimin gjate muajit paraardhes.

Likujdimi do te behet cdo muaj brenda 15-diteshit te pare te tij.

Afatet e ekzekutimit:

Sherbimi i Ruajtjes me roje private do te realizohet per periudhen nga data e nenshkrimit te kontrates deri me 31 dhjetor 2017.

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Sherbimi i Ruajtjes me roje private i godines se DSHP Lushnje dhe ambienteve qe ndodhen nen administrimin e saj –a) Godina e Poliklinikes Lushnje b) Godina e Drejtorise se Higjenes Lushnje dhe vlerave materiale qe ndodhen brenda godinave nga vjedhjet dhe demtimet. Qellimi: te ruaj me perkushtim objektet e lartpermendura, rendin ne to si dhe vlerat materiale brenda tyre nga vjedhjet dhe demtimet.

Detyrat:

- Te ruaj dhe siguroj objektet dhe vlerat materiale brenda tyre me perkushtim .
- Para marrjes se sherbimit te kontrolloj objektet dhe per cdo problem te konstatuar te njoftoj pergjegjesine rojeve .
- Per te marr kryerjen e sherbimit roja duhet te paraqitet 15 min para orarit. .
- Roja duhet te zbatohet vetem urdhrat e pergjegjesit te rojeve dhe titullarit te institucionit.
- Gjate kryerjes se sherbimit roja duhet te karakterizohet nga sjellja e qytetare ne komunikim.
- Gjate kryerjes se sherbimit i ndalohet kategorikisht pirja e alkolit si dhe fjetja.
- Gjate kryerjes se sherbimit te perdor armen sipas legjislacionit ne fuqi .
- Per cdo kundravajtje dhe veper penale te kryer ne objekt te informoj organet e rendit .
- Operatori ekonomik fitues mban pergjegjesi per demtimet, apo vjedhjet qe mund te ndodhin ne objektet qe ruhen nga ai kur keto te fundit vijne si rezultat i neglizhences se rojeve, mungeses se vigjilences se rojeve dhe mos organizimit te mire te sherbimit. Ne keto raste ai detyrohet te bej zhdemtimin e pasurise se demtuar apo te vjedhur sipas legjislacionit ne fuqi .

Shpërndarja:

Shpërndarja e rojeve do te realizohet sipas ndarjes se turneve ne objektet perkatese te specifikuar ne shtojcen 10 “Sherbimet dhe grafiku i ekzekutimit” duke filluar nga nenshkrimi i kontrates deri me 31.12.2017.

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

Sherbim i ruajtjes me roje private do te organizohet sipas specifikimeve te permdura ne shtojcen 10 “ Sherbimet dhe grafiku i ekzekutimit” dhe do te uloj me ruajtjen godinat dhe gjithe vlerat materiale qe ndodhen ne te .

